



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

---

Numri i lëndës: 2018:031796

Datë: 10.12.2018

Numri i dokumentit: 00199509

**P. nr.449/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. M. nga fshati G. Komuna e Deçanit, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore –DP në Gjakovë, PP/II.nr.630/2018 të 22.06.2018, në shqyrtimin gjyqësor, të mbajtur më datë **10.12.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **B. M.** nga fshati G. Komuna e Deçanit, i biri i S. dhe i nënë H. e gjinisë J, data e lindjes ... në Gjakovë, ka të kryer shkollën e mesme, student, i gjendjes së dobët ekonomike, i pamartuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me ID. ....

**Ë s h t ë f a j t o r:**

**Sepse:**

- me datë **17.04.2018** rreth orës **12:50** në rr. “...” në Gjakovë, pikërisht tek Shkolla e Mesme “Gj. N. K.” i shkakton lëndime të lehta trupore të cilat rezultojnë me dëmtim të përkohshëm të shëndetit të dëmtuarit Gj. L., në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte duke biseduar me të pandehurin dhe shokun e tij A. për një mosmarrëveshje që kohë më parë kishte pasur me ta, i pandehuri nga prapa e sulmon duke e goditur me shkreps të cilën e kishte në grushte, në kokë dhe në pjesë tjera të trupit deri është larguar nga shokët e tij, me c’rast të dëmtuarit Gj. L. i shkakton lëndime të lehta trupore të cilat lëndime më gjerësisht janë të konstatuara dhe të përshkuara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 26.05.2018 nga eksperti mjeko-ligjor Dr. D. H. dhe M. G.

**-me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-ës .**

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4,41,85,86 par. 1.2 dhe 5 të KPRK-ës neni 188/1-1.4 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

## VËREJTJE GJYQËSORE

Të akuzuarit **B. M.**, i bëhet me dije se ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën veprë penale dhe nëse ai sërish kryen veprë të tillë, gjykata do të i shqiptojë sanksion më të rëndë penal.

I dëmtuari Gj. L. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzime procedurale të paguahë shumë prej **20.00-€** si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej **20,00-€**, në afat prej **15** ditësh, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore DP në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.630/2018 të dt.22.06.2018, ka akuzuar të akuzuarin B. M. nga fshati B. Komuna e Deçanit, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala, në fillim të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 10.12.2018, ka lexuar aktakuzën PP/II.nr.630/2018 të datës 22.06.2018 dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari B. M. gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam pënduar për veprën e kryer, kërkojë falje nga i dëmtuari për lëndimin e shkaktuar premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe do të jem me i kujdesshëm, raportet tona janë të mira jemi pajtuar sipas traditave për çka e dhe i dëmtuari në prokurori ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demi pasi që jemi pajuar mese veti, i propozojë gjykatës që të merr parasysht rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimin e shprehur e gjykatë, premtimin se ne të ardhmen do të jem me i kujdesshëm, faktin se me parë nuk kam qenë i dënuar të me shqiptojë një dënim me të butë.

Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike të pranimi të fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ligjore dhe prova të mjaftueshme nga të cilët formohen të gjitha elementet e veprës penale me të cilën ngarkohet i akuzuari.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari B. M., ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale që i vihen në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bere në baza vullnetare duke u mbështetur edhe në fakte dhe prova që i përmbajnë aktakuzat ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326/4 të KPP-ës.

Me rastin e matjes dhe shqyrtimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform neni 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë në ndikim me rastin e dënimit. Ashtu që për të akuzuarin si rrethana lehtësuese gjeti se : i akuzuari e ka pranuar fajësinë, sjellja korrekte, rrethanat personale të tij student, i moshës së re, deklarimi i të dëmtuarit se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demi si

dhe faktin se i njëjti në të kaluarën nuk ka qenë i dënuar, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti. Nisur nga të gjitha këto Gjykata i shqiptoi **vërejtje gjyqësore**, me bindje se në rastin konkret është adekuate me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit. Gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë, pra, me vërejtje gjyqësore do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në dispozitën e nenit 41 të KPRK-ës, se kjo do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike u mur konform nenit 463 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale të përcaktuara nga gjykata dhe paushalli gjyqësor është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.449/18 më datë 10.12.2018.**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishnë.Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.